



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 46/2024  
Datë: 01/03/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, në-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Znj. Flutura Berbat - Zena, Zëvendësuese e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, caktohet ushtrues detyre e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij ti kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
1. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi është gjashtë (6) muaj fillon nga data 01/03/2024.
2. Obligohet Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 347/2022, i datës 20/12/2022.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pozita e Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese është pozitë e lirë, dhe znj. Flutura Berbat

- Zena me aktemërim AE. Nr. 01/2022 dt. 01.02.2022, i plotëson kushtet për t'u caktuar si ushtrues detyre në përputhje me nenin 35 (2) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke qenë se bënë pjesë në kategorinë e mesme drejtuese, që është kategori pasuese e kategorisë së lartë drejtuese. Duke pas parasysh faktin se pozita është vakante dhe me qëllim të mbarëvajtjes së punës në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, si dhe duke vepruar në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Flutura Berbati – Zena;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, dhe
- Arkivit e Ministrisë së Drejtësisë.